




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 26/1 prot
Shkruar 14/06/18



V E N D I M

Nr. 11 Datë 07.03.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT
UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT “KËRNAJA POWER” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr 111/2012 datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika 1/c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V e n d o s i:

- 1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit “**KËRNAJA POWER**” SH.P.K me administrator Z. Gëzim ISLAMI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Madh**, degë e Lumit të Bushtricës, për prodhim energjie elektrike (HEC Kërnaja 1), në fshatin Kërnajë, Njësia Administrative Tropojë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.
- 2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:
 - Shkatërron mjedisin dhe turizmin
 - Vështirësonte jetën sociale dhe ekonomike të banorëve me cënimin e ujit të pijshëm dhe ujit për nevojat e bujqësisë në zonë.
- 3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

